# BULETIN JAVOR
# 17-21 PRILL 2023

**Shprehja e javës**

Nëse mendoni se teknologjia mund të zgjidhë problemet tuaja të sigurisë, atëherë ju nuk i kuptoni as problemet, as teknologjinë!

**Përmbajtja:**

- **Akademia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike**
- **Locked Shields - ushtrimi kibernetik më i madh në botë**
- **Lajme mbi Data Breaches**
- **Patching Alert**



## AKADEMIA KOMBËTARE PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa, së bashku me drejtues të tjerë të Autoritetit, zhvilluan një takim me Znj. Claire Nantier, e ngarkuara me punë e Francës, Ambasadorin e Sllovenisë Z. Peter Japelj, dhe Z. Djordje Jankovic, i ngarkuari me punë i Malit të Zi. Qëllimi i takimit ishte adresimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, duke kërkuar që Qendra Rajonale e Sigurisë Kibernetike e ngritur në Podgoricë të zgjerohet edhe në Shqipëri, nëpërmjet ngritjes së Akademisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.

## LOCKED SHIELDS




Në datat 18-21 Prill në Tallin, Estoni u organizua ushtrimi kibernetik më i madh në botë. Në këtë aktivitet morën pjesë mbi 3000 ekspertë sigurie nga 38 shtete, të cilët testojnë aftësitë e tyre teknike nëpërmjet simulimeve Red dhe Blue Team.

Link: Locked Shields (ccdcoe.org)

Google Cloud Platform

Një vulnerabilitet në Google cloud platform i lejoi sulmuesit të modifikonin dhe fshihnin aplikacionet **OAuth** për të krijuar një *backdoor* për çdo llogari të Google.

Link: Google Cloud Platform Vulnerability Led to Stealthy Account Backdoors - SecurityWeek

## PATCHING ALERT

CISCO vmware

Cisco dhe VMware kanë publikuar disa përditësime sigurie, duke adresuar vulnerabilitete kritike të sigurisë në produktet e tyre, të cilat mund të shfrytëzohen nga aktorë keqdashës.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit të aplikojnë menjëherë përditësimet e sigurisë.

Link: Cisco and VMware Release Security Updates to Patch Critical Flaws in their Products (thehackernews.com)

Rruga "Papa Gjon Pali II", No.3
info@cesk.gov.al
Autoriteti Kombëtar për CESK
autoriteti_kombetar_cesk
+35542221039